



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



## Komuna e Istog

Opština Istok  
Istog Municipality

01 Numër:138/2018

Data:21.12.2018

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

### KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

**Për:** Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 44.1, 42 dhe nenit 54.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010,

### T H Ë R R A S

Mbledhjen e **12<sup>të</sup>** të rregullte e Legjislacionit të VI<sup>të</sup> të Kuvendit të Komunës. Mbledhja do të mbahet më: **28.12.2018, e Premte**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë **në ora 13:30**.

### R E N D     D I T E:

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Njoftimi me Raportin e punës NP “Ambienti” për vitin 2018 dhe aprovimi i listës së çmimeve për vitin 2019,
4. Njoftimi me Raportit e Përformances nga MAPL për punën e komunës së Istog për vitin 2017,
5. Njoftimi me Planin vjetor të punës së zyrës së Prokurimit për vitin 2019,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme private me pronën e paluajtshme publike për interes publik,
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së KKS-së për vitin 2019,
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

**KRYESUESI I KUVENDIT KOMUNAL,  
Z. QAUSH BALAJ**

### Vërejtje :

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë,  
t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

---

## KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

---

### P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 11<sup>-të</sup> e Legjislacionit të VI<sup>-të</sup> të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 30.11.2018, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                           |                            |
|---------------------------|----------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK;      | 13. Eliot Kukiqi, AAK;     |
| 2. Zenel Shatri, LDK;     | 14. Ardita Idrizaj, AAK;   |
| 3. Besa Ferati, LDK;      | 15. Jehonë Haxhijaj, AAK;  |
| 4. Naim Behlulaj, LDK;    | 16. Arben Kabashi, PDK;    |
| 5. Luljeta Zeqiraj, LDK;  | 17. Ajshe Metaj, PDK;      |
| 6. Haki Podrimaj, LDK;    | 18. Mirushe Sadikaj, PDK;  |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK;  | 19. Lavdije Bujupaj, VV;   |
| 8. Valbona Demaj, LDK;    | 20. Arif Elshani, AE;      |
| 9. Edona Lubeniqi, LDK;   | 21. Radoš Repanović, SL;   |
| 10. Naim Imeraj, AAK;     | 22. Radenko Belošević, RB; |
| 11. Nexhmedin Balaj, AAK; | 23. Slaviša Maliković, SM. |
| 12. Muhamet Ukaj, AAK;    |                            |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Nënkryetari i Komunës z. Agim Ademaj, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj.

Kryesuesi, përshëndet të pranishmit. Filloj me rendin e ditës për këtë mbledhje.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

## **R e n d     d i t e**

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019,
5. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

### **Kryesuesi i Kuvendit - Hedhe në miratim rendin e ditës:**

**U vendos:**

**Miratohet rendi i ditës**

**Me 20 vota për dhe 3 abstenime**

**Prezent në mbledhje 23 anëtar të Kuvendit**

### **Shqyrtimi i pikës 1.**

Në mbledhje mungon një anëtar i Kuvendit z. Agron Avdiaj VV, ndërsa tre anëtar të Kuvendit të cilët ende nuk janë zëvendësuar nga KQZ-ja për shkak se ende nuk janë certifikuar anëtarët dhe ne jemi sot vetëm me 23 anëtar prezentë.

### **Shqyrtimi i pikës 2.**

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

Arben Kabashi, PDK – përshëndet të gjithë të pranishmit, dua të cek që dhjetë mbledhjet e kaluara që kanë ndodhur në këtë mandat mund të them me plotë përgjegjësi së procesverbali me transparent që ka ndodh është i kësaj mbledhjes së kaluar, andaj ju kisha këshilluar dhe ju kisha imtu që mos të devijohet me në mënyra se çfarë ka ndodhur herëve të kaluara, kështu të vazhdojmë me një transparencë nga ana e fjalimeve të anëtareve të Kuvendit.

Arif Elshani, IQ – përshëndet të gjithë të pranishmit, deshta të them së kjo mbledhja e 11 dhe në këtë mbledhje procesverbali i kaluar sa i përket fjalimit tim është korrekt, dhe kërkoj që kjo korrektësi në të ardhmen të vazhdojë .

Kamë disa fjalë në lidhje me kërkesën e z. Shatri që ka kërkuar në mbledhjen e kaluar që anëtarët e Kuvendit të cilët nuk rrinë me e bë koriumin në mbledhje kryesisht ma ka përmend emrin mu dy here që të hiqet mëditja unë pajtohem që mu të me hiqet mëditja, që i tregoj z. Shatri se edhe nëse me hiqet mëditja fëmijët nuk me jesin pa bukë por nëse ne rregullore nuk thotë një gjë e tillë mendoj se Shatri duhet të shtim me një vendim posaçërisht veten dhe të hiqet ajo mëditje, edhe nëse me hiqet mëditja dy gjera do ti tregoj këtij Kuvendi edhe pse me dy mandate jam munduar me anëtarët e kuvendit të jem me korrekt asnjë nuk e kam kundërshtu nuk i kam thënë as një fjalë për asgjë dhe jam

munduar të mbaj korrektësi, edhe nëse me hiqet mëditja nuk ma ndalon hyrjen në këtë kuvend dhe nuk do të ma ndaloj fjalën e lirë timen të cilën do të shprehi çdo herë ju shumë mirë e dini që unë e kam fjalën e lire dhe me atë fjalë askënd në këtë kuvend nuk i kom ofendua asnjëherë. Por nëse z. Shatri mendon që q[ me sulmet e Arifit arrit në qeverisje le të me sulmon sa të do nune do ti bajë e kam pasur një mik të mirë por nuk e kam pritur që aj kryesisht do të kundërshtoj në emër të Arifit disa here.

Kryesuesi i Kuvendit – sa u potencuar biseda ndaj jush dhe të tjerëve nuk ka pasur ndonjë ofendim sa e di unë qëllim keq. Shpresoj që të gjithë të jeni në mbledhje, dhe askush të mos mbetet për mëditje.

Zenel Shatri , LDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, pasi që me u potencua emri po flas jo me u mbrojt as asgjë pasi që kom fol atë ditë do të flas edhe sot. Të gjithë e keni vërejtur se jo vetëm Arifi por edhe tjerët koleg që i kom përmende edhe dy a tre tjerë e jo vetëm ty z. Arif sepse është bërë dukuri se ne asambleistat vim e nënshkruhen flasim dy a tri fjalë e dalim ose nuk flasim hiq e dalim nuk e kamë pasur vetëm për ty ti merre si të duash sepse e drejt e jotja është, asgjë kundër teje nuk kamë as ndaj askujt hiq as atë ditë nuk kam pasur tendenca ndaj askujt pore shpeshherë po rrezikohet koriumi po vjen veç një gjysme ore 10 minuta po del ne po rrimë ter kohen dhe kamë kërkuar që Kuvendit të deklarohet dhe të merr qëndrim për raste të tilla jo vetëm për ty Arif por për të gjithë. Nuk kamë pasur asgjë kundër ndaj askujt tjetër për të gjithë e kam pasur andaj e kam cekur dhe kam thënë të partisë time dhe me tepër, e ti si e ke marr merre si të duash na miq jemi kanë miq mbesim, politika politikë vazhdon e sa për avancime politike ski nevojë me fol hiq.

Arif Elshani, IQ – deshta të them vetëm një gjë nëse ne e shikojmë mbledhjet qendrore partia juaj çdoherë hinë e del ashtu siç i konvenon politikës, dhe nëse në rregullore në ligj dhe në status nuk me obligon mu me ta bë koriumin ty si pozitë unë s’do të rri aty ku nuk kom dëshirën pluse s’ma plotëson mu dëshirën time nuk do të rri asnjëherë, pra mëditjet hiqmini që nga sot.

Kryesuesi i Kuvendit - Pasi që diskutime tjera nuk ka në lidhje me procesverbalin hedh në votim:

Kush është që të miratim procesverbalin,

**Kuvendi i Komunës vendosi :**

**Miratohet procesverbalin i mbledhjes së kaluar me shumicë votash**

**Me 20 vota për dhe 3 abstenime**

**Prezent në mbledhje 23 anëtar të Kuvendit**

### **Shqyrtimi i pikës 3**

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me piken e tretë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019;

Hysni Maxhari, Drejtor për Buxhet dhe Financa – prezantoi dhe sqaroi Projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019.

Naim Imeraj, AAK – përshëndet të gjithë të pranishmit, kisha dilemën që besoj që nuk mjafton të kaloj kjo pikë e rendit të ditës së paku pak pa e dhënë mendimin rreth asaj që është një diçka që e prekë në thelb interesin e qytetareve të komunës së Istogut, ne në vazhdimësi e dimi që kemi pasur problematika të inkasimit të tatimit në pronë ku ka qenë çështja vetëm për ndërtesa tani po e shtojmë edhe një segmente në atë detyrim të qytetareve duke e marrë parasysh që e kemi problematikë të trashëguar e që pak besoj, po nisna edhe prej përvojës personale kemi arritur ta azhurnojmë në këto 20 vitet e fundit pronësinë mbi titullarët të pronësisë mbi të gjitha ato elemente që kanë të bëjnë me pronën besoj që është një sfidë për Kuvendin Komunal dhe ne si anëtar të Kuvendit komunal për ekzekutivin për departamentin dikasterin e tatimit në pronë po ligji është ligj dhe ne vazhdojmë me tutje në shtet ndërtimin tonë u tha që janë normat minimale besoj që është mirë ajo që të fillohet me norma minimale se ka me pas probleme të cilat normimi ka me qenë problemi me i vogël ka me pese probleme barmë kam atë përshtypje mbetet si vit eksperimental, uroj që të kemi sukses në këtë drejtim edhe gjithnjë në atë përpjekjen që të taksa që vjelët nga qytetari të rikthehet në interes të qytetarit këto e din që shkojnë në të hyra vetanake e të hyrat vetanake e dimë që gjithnjë kemi përpjekje në planifikim që ti rikthehen në mënyrë me të mirë të qytetarëve dhe besoj që do të vazhdoj të ndodh ajo edhe në të ardhmen. Sa i përket draftit që është dhënë në dispozicion kisha pasur dëshirë që të rishikohet edhe një here aspekti i zonave e di që janë çështje teknike po ndodh që kamë vërejtur që nuk ka rrugë të emertume rruga që ku jam unë nuk ekziston po ekziston po e zëmë dy zonat rruga “Arben Januzi” kështu që pak të filtrohet kjo çështja e rrugëve e tek zonat nuk është ajo problematik të cilën na pengon neve ta implementojmë këtë draft të kësaj Rregulloreje. Edhe një here duke shprehur edhe në emër të grupit të AAK-së një dëshirë edhe një thirrje të qytetarëve të komunës së Istogut jemi të vetëdijshëm për problemet që dalin nga kjo rregullore.

Arben Kabashi, PDK – bazuar edhe në rregulloret tjera që kanë marr miratimin e Kuvendit e të cilat nuk kanë gjetur zbatueshmeri në të kaluarën si Rregullorja për transport vetëm se është votuar dhe është dalur në implementim po nuk është zbatuar deri në fundë që ne si kompetencë e dimë që menaxheri kryesor është kryetari aj që duhet me i nejtë gati që të zbatohen këto rregullore zbatueshmerin me vendimet e Kuvendit normat tatimore u fol që është minimale, nuk me pëlqej pak kjo për njësit bujqësore të parcelave se kemi pasur zonat kryesore parcelat që janë të ndara në kategori sidomos këto bujqësore që janë që jepen në shfrytëzim kanë gjetur zbatueshmeri ose obligimet ndaj fermerëve që janë paguar parcelat që janë dhënë në forma të ndryshme nuk ju kanë dhënë komunës ka qenë një çrregullim që ju kanë dhënë atyre ato prona dhe vet kuvendit komunal as kjo taks ose kjo normë tatimore 0.15% kërkoj që të ulet pak kjo normë të krijohet hapsirë në këto parcela të cilat shfrytëzohen për të mirë duke e ditur se komuna e Istogut është vend bujqësor, kërkoj të dilet edhe me një tarifa tatimore pak edhe me të ulet 0.10% pse jo, vet po e krijon ti atë mundësin që me pas qasje ma shumë fermerët këto tjerat është në rregull krejt çka kisha kërkuar me gjet zbatim kjo në implementim në të ardhmen, siç e ceka me here se të gjitha rregulloret po jeshin në letër nuk po zbatohen në teren.

Hyni Maxharraj, Drejtor për Buxhet dhe Financa – Arben në ligjin që përmenda të neni 9 të normat tatimore, të paragrafi 1.2 për njësit bujqësore të objekteve normat tatimore mund të variojnë në shkallët prej 0.15% deri në 0.50% ku minimalja është 0.15% ne nuk

mund të zbresim me shumë se kjo tarifa se lejon ligji. Ne i kemi propozuar normat me të luta që ligji na i lejon edhe për pronat bujqësore.

Muhamet Ukaj, AAK – përshëndet të gjithë të pranishmit, edhe unë ndaj shqetësimin me bashkëfolësit e me hershem, problemi nuk është të këto norma të tatimit sepse nuk jam ekspert i mirë i kësaj fushe nuk e njohë bash mirë. Problemi është se unë po nisna prek Kaliqanit i kemi shumë të paqarta do ndajmë pronat p.sh ka qenë një krye familjar para 60 vitesh disa prona janë në emër të tina ende, vetëm kisha dhënë një vërejtje që punëtorët që i njihni që i bëjnë këto taksa me pas pak me muajt me i dëshmuata ata me anëtar tjerë që janë duke i regjistruar, mos me ngarkua një njeri me prona e një mëhallë a një lagje këso raste në Kaliqan ka, por besoj që edhe në gjithë komunën e Istogut ka këso probleme.

Hyni Maxharraj, Drejtor për Buxhet dhe Financa – ky është shqetësim i të gjithëve ne hartimin e ligjit janë përkujdesur neni 3 të përkufizimet përfshihen të gjitha p.sh janë Autoriteti publik, bash posedimi, bashkëpronësia, certifikata, debitori, normat tatimore, detyrimet, faturat e tatimit në pronë etj, janë 46 terme që janë futur të ky ligj.

Ajshe Metaj, PDK – përshëndet të gjithë të pranishmit, duke e marr parasysh se tatimi në pronë të tokave nuk ka qene pas luftës ka qenë vetëm në fazën me herët sa e mbaj mend tokat nuk janë tatimuar deri me tani, kisha pasur një pyetje a janë të regjistruara të gjitha pronat duke e marr parasysh se me kalimin e kohës faktikisht parcelat janë ndarë sa janë të regjistruara në mënyrë që sa kini statistika sa janë të regjistruara të gjitha pronat atëherë puna mund të vazhdoj por paraprakisht nuk janë të regjistruara të gjitha parcelat që kanë ndryshua unë mendoj që duhet një here me dal me i këqyrë me i korrigjua a janë të regjistruara të gjitha parcelat a jo se nuk kemi si me i kërkua tatimin duke e marr parasysh se siç e potencoj Muhameti se përpara pronësia e tokave ka qen mbi një njeri e mandej njerëzit janë veçsu i kanë pas parcelat e veta janë nda janë në emër të tjetër kujt.

Hyni Maxharraj, Drejtor për Buxhet dhe Financa – të neni 6 i ligjit është e precizumë tatim paguesi 1. Tatimpaguesi është pronari i pronës së paluajtshme, 2 nëse pronari i pronës së paluajtshme ka vdekur ka pushuar se ekzistuar, nuk mund të përcaktohet ose nuk mund të gjendet, tatim pagues është personi i cili ligjërisht e posedon pronën e paluajtshme. 3 nëse pronari ose poseduesi i ligjshëm ka vdekë apo ka pushuar se ekzistuar, tatim pagues është personi i cili posedon token e paluajtshme. 4 në përputhje me kushtet e caktuara paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni në pronën e pa luajtshme për një vit i përket personit i cili ka në pronësi apo në posedim pronën e paluajtshme. 5 kur në posedim të një parcele tatimore janë në posedim 5 apo me shumë persona të gjithë kanë tatim pagues për pjesën e tyre të shfrytëzimit.

Zenel Shatri, LDK – sa i përket Rregullores për tatimin në pronë, nuk kam shumë çka të them janë disa gjera të rëndësishme që këtu nuk u ceken, ne jemi shku me tarifat me të ultë që është formuar shumë mirë , që qytetari të ngarkohet me pak, toka e punueshme dhe toka e pa punueshme, tokat e punueshme nuk do të paguhen tatimin ndërsa në ato të pa punueshme tatimohenë, nëse mundet dikush me na sqaruar se çka është tok e punueshme e çka e pa punueshme, përndryshe pajtohem plotësisht.

Hyni Maxharraj, Drejtor për Buxhet dhe Financa – komisioni nga ministria e Bujqësisë do ti vlerëson tokat të cilat janë të punueshme dhe cilat janë të pa punueshme ndërkohe do të dalin disa Udhëzime Administrative duke u bazuar në ligj nga ministrit përkatëse që ende nuk janë dalë. Edhe stafi ka me u trajnu ende veç e kanë ftesën për dhjetorë.

Arif Elshani, IQ – këtu shihet qartë se nga 1 janari ka hy në fuqi ligji mbi tatimin në tokat bujqësore që kemi pasur deri me sot mendoj që ky ligj i ngarkon me se tepërmi bujkun ata që do të tatimohen një pronë që janë të ngarkuar deri me sot nuk është në nivel Komunal por është qendror unë kisha dashur të them që ne si komunë kish qenë mirë që me hyrjen në fuqi të këtij ligji të fokusohemi me shumë në subvencione dhe grande që atyre bujqve tu epet mundësia që të punojnë atë tokë dhe të mos paguajna tatim për një tok të cilën e kanë pronë ndoshta dhe nuk e punojnë sa i përket ndarjes kategorizimit mendoj nuk është e drejt është dashtë me i lenë të gjitha ose të gjithë të pa tatimume se aty fillon tash e kom punu e se kom punu e kom mbjell ese kom mbjellë unë mendoj se me ato komisione mund të vine deri te manipulimi kjo është vërejtja ime është dashur me i shti një kategori jepjau mundësin të gjithëve me punu.

Hyni Maxharraj, Drejtor për Buxhet dhe Financa – ato toka që do të punohen nuk do të tatimohen, ministria e bujqësis kur të bën ndarjen e subvencioneve i ndanë, dhe ata që punojn tokat nuk do të tatimohen.

Ajshe Metaj, PDK - rreth tatimit kisha dashur me ditë a ka ndonjë kriter se sa sipërfaqe tokë mund te subvencionohet te tokat e punueshme a është e hektar a mundet që p.sh me pak se një hektar tok e punueshme te lirohet te behet subvencionimi i këtyre tokave te punueshme.

Hysni Maxharraj - sa te dalin udhëzimet administrative nga ministrit përkatëse që kanë hartua ligjin edhe do të përcaktohen këto kriteret jemi ne pritje deri me sot nuk kanë ardhur asgjë të gjitha komunat e Republikës së Kosovës janë duke i pritur se jam në kontakt me te gjithë kogelt, do të njoftohemi të gjithë për njëherë.

**Kuvendi i Komunës vendosi :**

**Miratohet Projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019, me shumicë votash**

**Me 19 vota për dhe 4 abstenime**

**Prezent në mbledhje 23 anëtar të Kuvendit**

#### **Shqyrtimi i pikës 4**

Kryesuesi i Kuvendit – propozon që të vazhdohet me piken e katërt të rendit të ditë Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019, Prezanton dhe sqaron këtë Planë.

Lexon rekomandimin nga Komiteti për Politikë e financa, pasi që aty u propozua që në plan të punës së Kuvendit për vitin 2019 të hy si pikë e rendit të ditës, Mbledhja solemne për nder të ditës së shkrimit të Istogut

Hedh në votim pyet anëtarët e Kuvendit se Kush është që kjo pikë të miratohet dhe si e tillë të hy në rend dite

Më shumicë votash miratohet që kjo pikë të hy në Planin e punës së Kuvendit për vitin 2019.

Arben Kabashi, PDK - duke par përvoja tjera të mandatit të kaluar por edhe tjera që kemi diskutu e kemi hartua planin e punës së Kuvendit, përveç këtyre obligative që janë për vitin e ardhshëm nuk kemi pasur diçka që ky komision ka pasur punë rreth planeve tjera po e zëmë p.sh po e dhe një rekomandim për tregjet rregullimi i tregjeve në komunën e Istogut duhet me u precizua me një Rregullore të veçantë në e kemi pasur të hartuar vitin e kaluar para vitit të kaluar në vitin 2017 ka qen e parapara kjo rregullore për muajin prill a thatë prapë kisha propozoj që të hyn si propozim rregullimi për tregjet në Komunën e Istogut, le të hyn në plan të del në diskutim publik një here mandej te hartohet një rregullohet e veçantë për tregjet në Komunën e Istogut.

Kryesuesi i Kuvendit - patëm një propozim konkret nga Arbeni që të hy në Planin e Punës Rregullorja për rregullimin e tregjeve, nëse ka dikush diçka nga ekzekutivi. Në hartimin e këtij plani jemi dakorduar që këtë rregullore mos ta shtimi në plan për arsye se kjo rregullohet me ligjin për tregjet, pasi që kjo Rregullore ka qen edhe disa here përpara dhe nuk është dal në kuvend janë disa dilema të çështja e kompetencave edhe një gjë po e them këto rregullore mund të futen edhe gjatë vitit kalendarik në i dimë procedurat e futjes në rend dite të hartimit të një Rregullorja por nuk ka gjë të keqe ia lë Kuvendit të vendos për këtë nëse ka dikush diçka rreth këtij propozimi urdhëroni.

Nënkryetari i Komunës - përshëndet të gjithë të pranishmit, nuk deshta sot ta marr fjalën por futja e kësaj rregullorje edhe Rregulloreve tjera në Planin e Punës e mos realizimi i tyre del me keq. Ju e përmendet se prej 2016 ka qen në plan dhe nuk është hy në rend dite. Rregulloret ekzekutivi mund ti punoj në faza të ndryshme dhe varësisht edhe prej ligjeve qëndrore që janë të varura shumë Rregullore tona që duhet të bazohen edhe në nivelin qëndror konsideroj se ndoshta me mirë është që kur nuk jemi të sigurt mos ti fusim në plan të punë se sa ti fusim në plan të Punës e mos ti realizojm, këtë nuk mund ta ndalojmë që ju ta fusni në Planin e Punës por një është mire më qenë në planin e punës dhe mos me u realizu.

Arben Kabashi, PDK - mu ligji ma lejon me propozu në Planë të Punës çfarëdo teme që është në interes të përgjithshëm të qytetarëve, atëherë ne jemi obligues ndaj vendimeve që i marrim qoftë ato për Rregullore të ndryshme që hartohen jemi bartësit ose prirësit e tyre, në kuadër të tyre është kryesorja që unë e përmenda në pikën tjetër është menaxheri kryesor Kryetari i komunës për Rregullore ose Projekt Rregullore të ndryshme, këqyren pak hartimin e Rregulloreve që i kanë bërë komunat tjera

Për rregullimin e tregjeve në Komunat e tyre thjesht po kërkoj që të dal në diskutim publik në muajin prill një Projekt Rregullore që rregullon mënyrën e tregjeve në komunën e Istogut, nuk janë pak por janë 5 a 6 tregje.

Ajshe Metaj, PDK - ne e diskutuam në KPF u diskutua aty por unë isha për ata që mos me u hjek kjo Rregullore jam për ata që ekzekutivi ta përpunoj duke i krahasuar me komunat tjera, se ne nëse nuk i menaxhojmë tregjet do të thotë se edhe buxheti i komunës në fakt nuk mbushet sepse mbushet nga taksat letë jetë një Rregullore letë unifikohet p.sh me Pejën ose komunat fqinjë si mund të bëhet dhe jam për ata që Rregullorja me ekzistua, vetëm se me u përpunua pak ajo Rregullore nëse nuk ka qene e përshtatshme dhe e pa zbatueshme, në muajin maj veç është në rend dite Rregullorja për menaxhimin e tregjeve. Kjo është kryesues ne e kemi pasur këtu në rend dite vetëm se kemi dashur ta largojmë pak.

Kryesuesi i Kuvendit - sqaron, kjo Rregullore ka qenë në planin e punës, nuk është punë kjo, propozimin e hartimin e Rregulloret e bënë Kryetari i Komunës ose 1/3 e anëtareve të Kuvendit ose 15% e qytetarëve që janë në listën votuese mund të mund të vine edhe nga shoqëria civile. Ne në KPF dhe në mbledhjet e mbajtura për hartimin e këtij plani ne e kemi diskutuar dhe ka mbetur që mos ta ngarkojmë mos ta obligojmë një far forme veten dhe mos ta obligojmë Planin e Punës me një çështje e cila mund të hy si pikë në rend dite edhe gjatë kohës kur ajo të punohet, por nëse jeni të dakordit mundemi edhe me e hedh në votim kush është që të jetë në planin e punës që këtë propozim të Arbenit ta kemi propozim për Rregullore ne plantë punës.

Arif Elshani, IQ - kam një kërkesë për planin e punës në vitet e kaluara ne edhe pse e kemi miratuar një plan në 30% i kemi diskutua pikat që kemi pasur, dhe kisha kërkuar me përpikëri që ju si kryesues të respektohet plani i punës edhe pse hyn pika të reja mos të na hekën këto pika që ne i kemi në tavolinë sot të respektohen dhe të hynë pika të reja sipas nevojës kush ka të drejt me shti kryetari , kryesuesi apo anëtarët e Kuvendit sa i përket tregjeve unë mendoj që propozimi i Arbenit është shumë me vend ne në Istog kemi disa tregje, nuk kemi Rregullore mbi tregjet kemi tregje edhe te uzurpuara në Gurrakoc është tregu i urzupum kemi biseduar disa here në këtë kuvend dhe kemi një pronë komunale që është e dedikuar si treg dhe sot është i uzurpuar dhe ne nuk bëmë Rregulloren po mendoj që është gabim. Duhet te vije një Rregullore mbi tregjet edhe të bihet një vendim këtu pronat komunale që janë të dedikume për tregje të funksionalizohen ne e dimë te enjten çka bëhet në Istog nuk kemi treg, duhet tregu të ketë derën hyrjen dhe daljen dhe shumë e rrugës është që të bije ma shpejt një rregullore nuk do të them në cilin muaj kjo m varet nga ekzekutivi Rregullorja mbi tregjet duhet të jetë në fuqi.

Naim Imeraj, AAK - pa intencë që me hy e me shqyrtua përmbajtjen që besoj që është bërë një punë e mirë e komisionit që e kemi autorizua që të punoj në emër të kuvendit për këtë Plan te punës së Kuvendit Komunal po për çështjen konkrete unë besoj që edhe në periudhat e kaluara po flas për planin e 2016 se për shkaqe të zhvillimeve shoqërore të 2017 nuk jemi marr me atë çështje po ka qene një arsye e cila vazhdon të ekzistoj që ka qenë ajo pikë e rendit të ditës përkatësisht nevoja që ne si komunë e Istogut ta kemi një Rregullore për menaxhimin e tregjeve a është e arsyeshme a nuk është mjafton me dal me pa qysh e kemi gjendjen e tregjeve qyshe menaxhohen çfarë infrastrukture kemi të tregjeve dhe besoj që së paku ne si anëtar të Kuvendit të Komunës dhe ekzekutivi duhet ta tregoj vullnetin që të punoj ne drejtim pozitiv që ato mangësi që janë evidente në menaxhimin e tregjeve respektivisht në ekzistimin dhe gjendjen ekzistuese të tregjeve të

profilizohen të Rregullohen aq sa jep kompetencë komunës ligji që është kompetentë, ne nuk mund të dalim mbi ligje sepse prape se prape kalon mbi shqyrtimin e ligjshmërisë po jam për ata që të rikthehen, nëse po mendoni që po bëjmë diçka të jashtëzakonshme nuk po bëjmë diçka të jashtëzakonshme unë mund ta citoj një pikë të rendit të ditës që kam qenë iniciator dikund është në mandatin e kaluar dhe tri plane i ka kaluar dhe vazhdon me qenë është një far antikorrupsioni në lëmin e prokurimit vazhdon me qenë dhe s'behet e vazhdon kështu. Nuk na bën gjë keq me qenë dhe mendoj që duhet të punohet në atë drejtim në emër të grupit të AAK- së kërkojmë që realisht të përkrahim propozimin që të jetë ne rend dite, pasi që muaji prill është me i shkarkuar në muajin prill të hy.

Zenel Shatri, LDK - propozimi i bërë për mendimin tim është me vend mirë po unë nuk e kam të qartë, këtë Rregullore mbi tregjet a duhet ta bëj ekzekutivi a duhet Kuvendi a kuvendi duhet ta debatoj e ta qesë në publik enë fund të vendos nëse ka ekzekutivi unë propozoj të caktohet një afat kur donë ta bëjnë dhe ne ta debatojmë në kuvend e ta aprovojmë. A në programin e Punës Kuvendit janë parapara këto pika unë jam që të aprovohet i tillë nuk është problem me hy edhe ajo pik e rendit të ditës. Mirëpo kompetencat të kujt janë a të ekzekutivit a të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit - kompetencë për hartimin e Rregulloreve është nga ekzekutivi, por ka mundësi edhe 1/3 e anëtareve të Kuvendit ta hartojnë një draft Rregullore dhe ta parashtrojnë.

Zenel Shatri, LDK - unë mendova që ekzekutivi ne mos me ber 15% propozoj që ekzekutivit, ose ne si Kuvend një afat deri kur mund ta bëjnë një rregullore të tillë dhe ne ta shqyrtojmë.

Enver Rugova, Drejtor i Shërbimeve Publike - sa i përket tregjeve duhet me specifiku a duhet ne të gjitha tregjet apo një treg senesë është çështja e të gjitha tregjeve i kemi tregjet e ndryshme e kemi tregun e kafshëve, i kemi tregjet ne Istog ne Gurrakoc edhe në Banjë. Ne jemi marr intensivit me këtë edhe drejtori paraprak edhe unë së bashku me të edhe një pjesë e kolegeve tanë pa marr parasysh ngjyra politike mirë po ajo me vete ngërthen një kosto shumë të lartë financiare aktivizimi dhe investime shumë të mëdha p.sh rregullimi i tregut në Istog është shumë i nevojshëm është i rrethuar i ka ato hyrjet e veta mund të rregullohet mirë po investime donë kompletë tregjet me e rregullu ne Istog që ka vlerë ndoshta deri ne 100 mijë euro, në Gurrakoc është lokacioni edhe aty nuk ka funksionu ai treg kurrë që është ndërtuar në vitet e 90-ta dikundë për me e ndreq të ri edhe ajo kërkon mjete të mëdha gjithashtu edhe në Banjë është lokacioni aty donë investime të mëdha ky është një projekt i madh ne Rregullore mundë të bëjmë ajo nuk është fare problem i kanë disa komuna nuk i kanë të gjitha ne jemi në kontakt edhe nëpër mbledhje të ndryshme me drejtoret e shërbimeve publike e as që mendojnë as që kanë fillu me këtë i kemi tregun e kafshëve nalt prej se ka dal nga qyteti këtu i ka humb vlera atij tregu, për shkak të largësia për shkak të disa procedurave tjera edhe kushteve jo ndoshta me të mira që i ka aty aj treg, aj treg është privat që ju ka dhen para një kohe jo shumë të hershme pata 10 viteve kështu që Rregulloren futni lirisht ne mund ta punojmë me implementu është me kosto shumë të lartë.

Arif Elshani, IQ - Rregullorja me investime janë dy bota të kundërta ne e bimë rregulloren e investimet i bëjmë kur ti kemi paret dhe e dyta a dojmë me pru për një treg apo për të gjitha tregjet ne jemi në komunën e Istogut a duhet me i pru për të gjitha tregjet Rregulloret nuk mundemi me e nda po e dua Istogun e po i la tjerat Rregullorja duhet të përfshihen të gjitha tregjet dhe tregu privat çfarë statusi ka nuk e di por rregullorja nuk e pengon investimet, investimet i bëjmë pas tri viteve ndoshta ja dhëm dikujt publiko privat me e rregullu këtë treg dhe e rregullojmë punën kështu që unë mendoj që rregullorja është shumë e nevojshme për komunën e Istogut.

Arben Kabashi, PDK - ideja ime ke që ka qen edhe në mandatin e kaluar ekzekutivi e bën një rregullore Enveri pak e kalkuloj po pak e stërgjati këtë po bëhet kategorizimi në atë rregullore nga ekspert të ndryshëm si i parashohin tregjet në Komunën e Istogut nuk ka gjë të keqe ajo vjen në kuvend me pëlqimin e Kuvendit del në diskutim publik prape kthehet në kuvend në kuvend e diskutoj dhamë ide për një rregullore afatgjate me i jep rekomandimet se si duhet të jetë rregullorja është shumë e thjeshte.

Haki Podrimaj, LDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, kam qenë anëtar i komisionit për planin e punës dhe dy here jemi taku dhe në dy takimet bukur gjate kemi bisedua për këto rregullore edhe ne si komision kemi marr një vendim jo për me e eliminua me e hjek për vitin 2019 për mos të hy në rend dite një Rregullore mirëpo ju ka lenë kryesuesit që në bashkëpunim me ekzekutivin dhe drejtorin përkatëse së në çfarëdo momenti që ta mund ta përgatisin këtë Rregullore ta fisin në rend dite në kuvend për miratim, nuk kemi dashur që në fund të vitit të dal si pik e pa realizuar dhe pas as një qellim tjetër nuk e kemi len këtë pikë. Prape ne jemi të gatshëm ta aprovojmë këtë rregullore kur ta sjell ekzekutivi.

Kryesuesi i Kuvendit- hedh në miratim propozimin e Arbenit qe të hy si pik e rendit të ditës Rregullorja për menaxhimin e tregjeve në komunën e Istogut.

Ne plan të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019,

Miratohet një zëri nga anëtarët prezent

Kryesuesi i Kuvendit – hedh në votim Planin e Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019,

**Kuvendi Komunal me shumicë votash vendosi:**

**Që Plani i Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019,**

**Miratohet me 21 vota për, dhe 2 abstenime.**

**23 anëtar prezent,**

## **Shqyrtimi i pikës 5**

Kryesuesi i Kuvendit - propozon që të vazhdohet me piken e pestë të rendit të ditës Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Arif Elshani, IQ – i kam për këtë pikë të rendit të ditës 3 pyetje dhe kërkoj që të me epen me shkrim në mbledhjen e ardhshme nën 1. Banja e Istogut nuk ka ujë nëntë muaj, dua të di ku është problemi deri ku ka mbërri dhe si është planifikimi i zgjedhjes së problemit të ujit për Banjën. 2 Në këtë kuvend në legjislacionin e kaluar kemi miratuar një Rregullore për subvencionimin e rasteve të vdekjes sociale kemi prurë një rregullore që kemi caktuar raste sociale kur ka vdekje me ju paguar me mbi 100 euro (100 ose 170), a po implementimet kjo Rregullore a kanë filluar të ndahen ato mjete dhe ku kanë mbërri. 3 Po në këtë Kuvend kemi aprovuar Saradrinin si qendër urbane, po dua të di çka po ngjan me Saradrinin a është qendër urbane vetëm në letër, apo ka diçka ndonjë keq planifikim në këtë legjislacion që Saradrini të ndryshon të marrë epitetin e qendrës urbane.

Arben Kabashi, PDK - i kam dy pyetje të dytë janë për drejtorin e shërbimeve publike nuk e di çka Enver por jeni njeri shumë i mirë shumë korrekt.

Nuk e di sa ki informacion deri me sot a e keni bërë komisionin për pranimin e punëve, ose në përcjellje të punëve që është duke u bërë në komunën e Istogut po e zëmë trotuarin në Gurrakoc që shkon në drejtim të Klinës, në përfundim të qendrës që ka mbetur në gjysmë trotuari nuk e di sa metra saktësisht po dua të dal të pyetja ka qenë dikund 1 metër e diçka trotuari i zgjerim d.m.th gjerësia e trotuarit ndërsa ky projekti i ri që është duke u implementuar që po shihet që nuk është duke u përfundua në bazë të afatit se ne jemi mësu kesi soj nuk përfundon afati veç erdh përfundimi është veç në gjysmë vazhdimi i trotuarit të them shumë nuk e di se nuk e kam mat me metër por dua me matë me qene korrektë edhe para qytetarëve se tek e fundit janë taksat tona atje kjo është në përfundim të qendrës së Gurrakocit e deri të lagja e Feratve që është tu përfundua ky projekt dikund është gjysmë metër mos të them krejt gjysmë metër po afër gjysmë metër është ngushtica se sa ajo pjesa e parë që është krye prej qendrës a është kështu më qëllim apo është hartuar kështu është parapara apo kua është qëllimi, unë projektin nuk e kam parë nuk me ka ardhë mirë mu po as nuk ju ka ardh mirë qytetarëve atje para se me u shtua gjerësia e trotuarit për shkak së është frekuentim shumë i madh aty i këmbësoreve.

2 ka të bëjë me stacionin e autobusëve që jemi bërë bozë duke e përmendur e pamë atje edhe në plan në punës muajin e tret atjea ki ndërmar diçka që me e lehtësu ose si me e cek ma mirë një propozim ose nja harmonizim edhe me bordin atje qe udhëheqin stacionin e Autobusëve qen me e kalua pak atë ngërç që e kanë të borxheve që ne po e shohim në implementim të borxheve që po ankohemi nuk është duke u implementim rregullorja hiq tash nuk kam par as inspektor në bazë të Rregullores që është në përpikmeri të asaj rregulloreje që del Autobusat nuk janë duke ju përmbajtur asaj Rregulloreje dështa të di a e kemi kaluar agë ngërç që është.

Enver Rugova, drejtor i shërbimeve publike – Arben trotuari i pa përfunduar trotuari në Gurrakoc ka qen në dinamik tamen të punëve edhe në dinamik të kryerjes dhe konkretisht kanë kërkuar disa shtëpi të lagjes Fetahaj që u zënë ajo aty aj kanali uji skish ka me kalua dhe u bëjke një pus i madh aty që faktikisht edhe banoret aty po edhe qytetaret kalimtarët asajde ka qen një ndjenjë jo e mirë e kanë evitua atë është asfaltua aty e kanë mbulo shkëlqyeshëm trotuari në Gurrakoc nuk e di sa je i njoftum tash ka me u vendos edhe ndriçimi publik asaj ane ku nuk është përfunduar dhe kompanitë janë duke u marr vesh mes veti që duhet me u germu për mos me u prish trotuari deri oshtë nënshkrua kontrata në prokurim aj e ka prit këtë i ka vendos anësoret e krejt po për mos me u prish prape

trotuari si të ndreqet me u germu prape e ka prit dhe është në marrëveshjet me mbikëqyrshin me mu dhe me kompaninë, se kompania moti e kish përfundua atë punë. Sa i përket të trotuari 1m e 80 është me anësore trotuari që ka qene i vjetër 1m e 40 është ky me anësore ose 1m e 20 me 1m e 40 në të dy anët projektuesi e ka parë sepse në të dy anët e rrugës po vendoset trotuari nuk është pak që në të dy anët të vendoset trotuari me ka në 1m e 40, 2m e 80 as nuk është ndonjë problem që na pengon se kam dëgjuar në Gurrakoc disa njerëz që nuk e di a kanë qenë në opozitë a çka ata veç si do të qvindrohem ne dy veta unë e di se dy vetura mund të qvindrohen aty se njerëzit e kanë atë ndjenjë se ka të shkojnë 1m e 40 mund të ecin lirshëm a frontal ka 4 a 5 ata jo.

Arben Kabashi, PDK – ky trotuari 1m e 40 nuk është.

Enver Rugova, Edhe në të dy anët me trotuar tamon do të bëhet ajo rrugë si është hyrja e Gurrakocit tamon rrugë moderne është asfaltuar në të dy anët trotuari vendoset ndriçimi publik dhe s'po di çka tjetër, ti ki të drejt me e bë pyetjen je këshilltar ne dej dje këtu jemi kanë i dimë këto punë po, trotuari në Gurrakoc është i shkëlqyer. Sa i përket Stacionit të Autobusëve shumë shpejt do ta keni një raport të punës dhe do të jetë pikë e rendit të ditës për debatimin e punës, ka përmirësime të dukshme po në raport do ti vendosi të gjitha.

Arben Kabashi, PDK – unë do ta masë me metër atë trotuar, e dini se edhe për kanalet e ujerave të zeza e kam matë dhe jam kanë preciz në kuptimin e taksave të qytetareve vet Enveri e ka pas precizua thojke 1m e 50 fellsia e një ujësjellësi në Gurrakoc dul që është 60 e diçka cantin e kom pas pru këtu, andaj mos po i del edhe ky trotuar ashtu, unë thash komisioni a është në mbiqkyrje të atij projekti se nuk është hiq dhe bëra pyetje rreth gjerësisë së atij trotuari, tha dikush që është Kaliforni nuk është Kaliforni zotëri se nuk është as një investim në mandatin e kaluar në komunën e Istogut në Infrastruktura nuk ka qenë andaj të jemi të sinqerisht se ajo rrugë ka qene e frekuentua me, kanë ndodhur fatkeqësi të ndryshme në komunikacion.

Pasi që nuk pati diskutime të tjera, Kryesuesi shpalli të mbyllur mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:35

**Procesmbajtëse,  
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues,  
Qaush Balaj**



Nr. 7676/2014

Date 13-11-2014

### Çmimet e Shërbimeve - Tarifat

| Kategoria e Konsumatorve                                   | Numri i Konsumatorve                        | Tarifa për Konsumatorë Me njësit matëse pa TVSH | TVSH | Tarifa për Konsumatorë me Njësi Matëse me Tvsh |
|------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|-------------------------------------------------|------|------------------------------------------------|
| Shtëpiake                                                  | Derë për Derë                               | 4.31                                            | 0.34 | 4.65                                           |
|                                                            | Me Kontenjerë                               | 4.31                                            | 0.34 | 4.65                                           |
| Komerzial Industrial                                       | Nën kategoria e I-rë                        | 5.00                                            | 0.40 | 5.40                                           |
|                                                            | Nën kategoria e II- të                      | 8.62                                            | 0.69 | 9.31                                           |
|                                                            | Në kategoria Eiii- të                       | 15.52                                           | 1.25 | 16.76                                          |
|                                                            | Nën kategoria e IV-ërt                      | 17.24                                           | 1.38 | 18.62                                          |
| Komerzial Industrial me Kontratë dhe Kontenjerë të Veçantë | Kontenjeretë 1.1 m <sup>3</sup> një Zbrazje | 11.21                                           | 1.79 | 13.00                                          |
|                                                            | Kontenjeretë 5-7m <sup>3</sup> një zbrazje  | 35.00                                           | 5.00 | 40.00                                          |

Vërejtje. Sipas Rregullatorit Subjektet- Bizneset të cilët marrin sipas kontratës Kontenjerët 1.1 m<sup>3</sup>, janë të obliguar që ti paguajnë (pa marrë parasysh zbrazjet) 39.00 euro që u pranohen si tri zbrazje plus u llogariten zbrazjet që janë më shumë se tri.

Ketu hynë Qendrat tregtare ,Supermarketet ,Restorantet e mdhaja që kanë edhe sallën e dasmave .SHërbimi Korrektus,FSK,Institucionet. Shkollat Etj.

### Llojet e Bizneseve – Kategorizimi

